

BLLOKU I SHËNIMEVE

PËR KONFERENCËN

E PËRGJITHSHME



ËSHTË KOHA TA FORCOSH DËSHMINË TËNDE, TË VISH MË PRANË Jezu KRISHTIT DHE TË MARRËSH ZBULESË VETJAKE.

"Jam lutur . . . që kjo konferencë të jetë një kohë përtëritjeje shpirtërore për secilin prej jush. . . . Qoftë kjo konferencë një kohë paqeje dhe gostie shpirtërore për ju! Kërkofshi dhe marrshi zbulësë vetjake gjatë këtyre sesioneve!"

Presidenti Rasëll M. Nelson¹

PYET

"Zbulesa e kulluar për pyetjet në zemrën tuaj, do ta bëjë këtë konferencë shpërblyese dhe të paharrueshme."

Presidenti Rasëll M. Nelson²

DHE MË PAS DËGJO

A ke ndonjë pyetje ose shqetësim në mendjen tënde pikërisht tani? Ndoshta je i/e shqetësuar për të gjetur miq të mirë që do të të ngrenë moralin dhe inkurajojnë. Mund të pyesësh veten se si ta përmirësosh vetëvlerësimin tënd ose të kujtosh identitetin tënd hyjnor. Ndoshta po përpiqesh të vendosësh se në cilin universitet të bësh kërkesë për pranim. Ose mund të jesh thjesht i/e shqetësuar në përgjithësi për të ardhmen, me kaç shumë konflikt dhe zemërim në botë.



ÇFARË KE NË MENDJE?

Do të mësosh më shumë nga konferenca e përgjithshme nëse i mban pyetjet dhe shqetësimet në mendjen tënde. Zoti do të të ndihmojë të gjesh përgjigje teksa e hap zemrën dhe i dëgjon shërbëtorët e Tij.



Pyetjet:



Përgjigjet:




“Perëndia njëmend do t’i nderojë besëlidhjet dhe premtimet e Tij ndaj secilit prej nesh. Nuk kemi përse shqetësohemi për këtë. . . . Ne bëjmë më të mirën tonë, por duhet t’ia lëmë Atij administrimin e bekimeve, si materiale edhe shpirtërore.”

Plaku D. Tod Kristoferson³

TË MËSUARIT NËPËRMJET TEMAVE

A ke gjetur ndonjë temë te bisedat që ke dëgjuar? A ka ndonjë që është e rëndësishme për ty tani?

 Temat:

 Ç'Kuptim Ka Kjo për Mua:



NUK TË PËLQEN TË SHKRUASH?

Askush nuk ka thënë që duhet t'i shkruash shënimet e tua të konferencës. Në vend të kësaj mund t'i vizatosh shënimet, nëse kjo të ndihmon t'i rrokësh më mirë mendimet e tua. Bëj atë që funksionon për ty!

NDJENJAT DHE MBRESAT E MIA





"Në këto dy fjalë – 'Dëgjojeni Atë' – Perëndia na jep modelin për sukses, lumturi dhe gëzim në këtë jetë. Ne duhet t'i *dëgjojmë* fjalët e Zotit, t'i *mbajmë vesh* ato dhe t'i *kushtojmë vëmendje* asaj që Ai na ka thënë!"

Presidenti Rasëll M. Nelson⁴



BISEDA E PARAPËLQYER

A ke ndonjë bisedë të parapëlqyer që e ke dëgjuar këtë konferencë? Merr parasysh të shkruash emrin e folësit, për çfarë flet biseda dhe pse të pëlqeu aq shumë.

KOHA PËR TË REFLEKTUAR

Sapo të mbarojë konferenca, është koha që të punosh me gjërat që ke dëgjuar dhe ndier. Këtu janë disa pyetje për t'ia filluar:

- Cila është ajo gjë ku mund të përqendrohem teksa shkoj përpara?
- A ka ndonjë gjë në jetën time që më nevojitet ta ndryshoj?
- Si mund ta forcoj dëshminë time për profetët e gjallë?
- Si mund të rritet dashuria ime për Shpëtimtarin?
- A ka gjëra që mund të bëj për ta dëgjuar Atë më mirë në jetën time të përditshme?
- Pyetje të tjera që ke:



“Po, ne duhet të mësojmë nga e kaluara dhe po, ne duhet të përgatitemi për të ardhmen. Por vetëm *tani* mund të veprojmë. *Tani* është koha kur mund të mësojmë. *Tani* është koha kur mund të pendohemi. *Tani* është koha kur mund t’i bekojmë të tjerët.”

Presidenti Rasëll M. Nelson⁵

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Predikimi i Ungjillit të Paqes”, konferenca e përgjithshme e prillit 2022 (*Liahona*, maj 2022, f. 6, 7).
2. Rasëll M. Nelson, “E Vërtetë e Kulluar, Doktrinë e Kulluar dhe Zbulësë e Kulluar”, konferenca e përgjithshme e tetorit 2021 (*Liahona*, nëntor 2021, f. 7).
3. D. Tod Kristoferson, konferenca e përgjithshme e prillit 2022 (*Liahona*, maj 2022, f. 78, 79).
4. Rasëll M. Nelson, “Dëgjojeni Atë”, konferenca e përgjithshme e prillit 2020 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2020, f. 89).
5. Rasëll M. Nelson, “Tani Është Koha”, konferenca e përgjithshme e prillit 2022 (*Liahona*, maj 2022, f. 126).


© 2023 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved.

LEJJA PËR TA RISHTYPUR NË LETËR KËTË BROSHURË JEPET PËR PËRDORIM VETJAK, JO PËR TREGTI. KJO PËRFSHIN LEJEN QË UDHËHOQËSIT E LAGJES TË SHTYPIN NË LETËR NJË NUMËR TË VOGËL KOPJESH PËR ATA TË CILËVE U SHËRBEJNË BRENDË KUADRIT TË THIRRJEVE TË TYRE. BROSHURAT DUHET TË SHTYPEN TË PLOTA. KJO NUK PËRFSHIN LEJEN QË KY MATERIAL TË AFISHOHET NË INTERNET, TË RIPËRDORET OSE TË SHPËRNDARHET. ÇDO PËRDORIM SHITESË I KËTJË MATERIALI KËRKON LEJE.

permissions.ChurchofJesusChrist.org

KE NEVOJË PËR MË SHUMË KOPJE?

Shkarkoje dhe shtype në letër këtë bllok shënimesh te conference.ChurchofJesusChrist.org.



KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME